

**TRYEZË SHKENCORE “QASJE SHKENCORE MBI VEPRËN
E ETËHEM HAXHIADEMIT: FTESË E SHTYSË PËR NJË RILEXIM
TË DRAMATIKËS SË TIJ”**

Më datën 27 prill 2022, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Departamentin e Studimeve Letrare të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (ASA), organizoi tryezën shkencore me temë ”Qasje shkencore mbi veprën e Etëhem Haxhiademit: ftesë e shtysë për një rilexim të dramatikës së tij”. Në tryezën e mbajtur në kuadër të 120-vjetorit të lindjes së autorit, dramaturgut, përpiluesit e shqipëruetit Etëhem Haxhiademi, të drejtuar nga prof. as. dr. Evalda Paci dhe dr. Arian Leka, u shtruan për diskutim një sërë çështjesh, që prireshin ndaj nënvizimit të aspekteve themelore të shkrimtarisë së autorit, të rendit kronologjik e stilografik të përvijimit të tyre, të dimensioneve themelore që receptohen në veprat e tij, si dhe në vendin që i përket këtij të fundit në sistemin letrar të periudhës në të cilën zhvilloi veprimtarinë e tij krijuese. Kultivues i një sërë modelesh gjinore, autor përpilimesh të veçanta për nga ndërtimi dhe brendia, njohës i mirë i traditës letrare e socioletrare të kulturës antike, Haxhiademi rivjen dhe në vëmendjen e studiuesve që u bënë pjesë e kësaj tryeze, duke shtruar dhe paraqitur për diskutim tematikat e sipërcituara.

Prof.dr. Tomorr Plangarica (Institutit i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASA) u paraqit me temën me titull “Haxhiademi i rilexuar”; Dr. Arian Leka (Institutit i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASA), u paraqit me temën “Etëhem Haxhiademi mes cilësimeve dhe vetëpërcaktimit (taksonomi letrare, si metodologji për klasifikimin cilësor të krijimtarisë së Etëhem Haxhiademit)”; Prof. as. dr. Evalda Paci (Institutit i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASA), u paraqit me temën ”Elemente institucionale të botës antike në shkrimtarinë e E. Haxhiademit”; prof. as. dr. Emin Z. Emini (Universiteti i Prishtinës) u paraqit me temën “Dimensioni etik si funksion estetik në dramaturgjinë e E. Haxhiademit”; akad. prof. dr. Shaban Sinani (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) përmbylli ciklin e paraqitjeve, duke u përqendruar në kontekstualizimin e kontributeve të E. Haxhiademit në sistemin letrar të periudhës kur shkroi.

Në këtë veprimtari të rëndësishme shkencore u rimor çështja e njohjes së thelluar të teksteve të veprave të E.Haxhiademit, por dhe e traditës letrare që ka ndikuar në formimin dhe rrugëtimin individual të tij. Një sërë argumentesh me interes u cekën dhe në proces të diskutimeve nga pjesëmarrësit që e përmbyllën këtë veprimtari.

Evalda Paci

